

D.TEKNIKE

1. Lidhur me aftësitë teknike e profesionale, Ofertuesi duhet të përmbushë minimalisht kërkesat e mëposhtme :

a- Ofertuesi duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo me pak se 35 % te fondit limit pa përfshirë vlerën e tvsh, të realizuara gjate 3 (tre) viteve te fundit.

Kontrata te realizuara me autoritete kontaktore te cilat detyrimisht duhet te jene te shoqeruara me vertetimin e realizimit me sukses te saj, leshuar nga autoriteti kontraktor. Per punime te realizuara me subjekte private operatori ekonomik te paraqese faturat tatimore te shitjes, (ku te shprehen qarte datat, shumat, sasite, emertimet, vlerat).

2. Licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punimeve:

i. Liçenca profesionale e shoqërisë e vlefsheme në kategorite :

Kategoria Klasifikimi Emertimi i kategorise

N.P – 1	A	Punime gërmimi në tokë
N.P - 5	A	Punime nëntokësore, ura e vepra arti
N.P - 7	A	Ujesjellësa, gazësjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.
N.P - 12	A	Punime te inxhinierisë së mjedisit
N.S - 1	A	Punime për prishjen e ndërtimeve
N.S - 7	A	Barriera mbrojtëse rrugore

ii. Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikat ISO si me poshte:

I. ISO 9001:2008 (për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)

II. ISO 14001:2004 (për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit)

III. OHSAS 18001:2007 (për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë)

Çertifikat ISO ne rastin e bashkimit te perkohshem te shoqerive duhet te paraqiten nga sejcila shoqeri.

(Çertifikat ISO nëse janë në gjuhë të huaj duhet të përkthehen dhe noterizohet në gjuhën shqipe.)

3. Operatori ekonomik duhet të ketë si pjesë të stafit minimalisht një inxhinier ndertimi dhe një inxhinier mekanik, e vërtetuar kjo me listpagesat e shoqërisë.

Inxhinier ndërtimi si drejtues teknik të punimeve me experience 10 deri në 15 vite përvojë pune në fushën e mësipërme , me kontrat pune dhe të përfshirë në listëpagesën e Ofertuesit .

Kërkohet që drejtuesi teknik të ketë 10 deri në 15 vite përvoj pune në fushen e mesipërme duke u bazuar në vështirësin që ka ky projekt për tu ndertuar.

4. Operatori ekonomik duhet te kete një punësim mesatar i të paktën 30 personash me ditë të plota, për periudhën Janar 2015 – Korrik 2016 e

D.TEKNIKE

dokumentuar kjo me vërtetimin e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga Administrata Tatimore.

-Në këtë numër përfshihet edhe stafi drejtues. Kjo të dëshmohet me vërtetim nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguruar për çdo muaj si dhe me E-SIG (Deklarata "Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi") Këto listpagesa për gjithë periudhën duhet të jenë të vërtetuara nga dega e Tatim Taksave.

Kërkesa për të paktën 30 punonjës bazohet në territorin e vështirë ku shtrihet projekti dhe shpejtësia e realizimit të punimeve.

5. Operatori ekonomik duhet të disponojë ose të ketë mundësin e sigurtë të disponimit në paisje t/kapacitet e mëposhtëme teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

- **Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet e makinerite e me poshtme:**

Lloji I Makinerive	Sasia	Pronesia
Kamion Transporti mbi 18 ton	Cop 1	ne pronesi ose me qera
Eskavator me zinxhir	Cop 1	ne pronesi ose me qera
Fadrome	Cop 1	ne pronesi ose me qera
Autobetoniere	Cop 1	ne pronesi ose me qera
Rrul vibrues	Cop 1	ne pronesi ose me qera
Gjenarator	Cop 1	ne pronesi ose me qera
Kompresor per thyerje betoni	Cop 1	ne pronesi ose me qera
Pomp uji	Cop 1	ne pronesi ose me qera

Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit. Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit në Republikën e Shqipërisë dhe faturat tatimore të blerjes.

Për mjetet e marra me qira/furnizim, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë/furnizimit ku të specifikohet afati i kontratës, shoqëruar me: për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit. Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit në Republikën e Shqipërisë dhe faturat tatimore të blerjes. Për çdo mjet të paraqiten fotot përkatëse për identifikimin e mjetit.

Administratori i shoqërisë ofertuese, duhet të paraqesë deklaratë që makineritë e mësipërme nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera por vetëm për këtë objekt. Kërkesat si më sipër duhen plotësuar nga të gjithë aplikantët. Mungesa e plotësimit të njërit prej kërkesave vec e vec ose si bashkim operatorësh si dhe paraqitja e dokumentave të rreme e bent të pa vlefshme ofertën e cilido operator ekonomik dhe ndaj tyre do të zbatohen kërkesat e ligjit të Prokurimit Publik.

6. Afati i përfundimit të punimeve të jetë 120 ditë nga data e lidhjes së kontrates.